

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Biljana Rexhiq anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Shaban Prekalla, në çështjen penale kundër të akuzuarës E.B., nga Gjilani, për shkak të veprës penale Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, nga neni 317 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-ës, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, P.nr.38/2013, datë 19.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 22.01.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, P.nr.38/2013, datë 19.11.2018, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, me aktgjykimin P.nr.38/13, datë 19.11.2018, të akuzuarën E.B. e ka shpall fajtor për shkak të veprës penale Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, nga neni 317 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-ës, dhe e ka gjykuar me dënim me kusht me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj, ekzekutimi i të cilit dënim nuk do të bëhet nëse e akuzuara brenda afatit prej 2 (dy) vite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale, në rast se e njëjta kryen vepër tjetër penale brenda afatit të verifikimit atëherë dënimi me kusht do të revokohet në dënim me burg. Është obliguar e akuzuara që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit me kanosje përmbarimi, si dhe në kuptim të nenit 39 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe atë vetëm për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë ashtu që të akuzuarës ti shqiptoj dënim me të ashpër.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.30/2019, datë 17.01.2019, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarës t'i shqiptohet dënim më i ashpër

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuara.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase as në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimin që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Sa i përket vendimit për dënim, prokurori me ankesë pretendon se edhe pse gjendja faktike është vërtetuar drejtë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, por gjykata nuk i ka shqiptuar të akuzuarës dënim të merituar sipas ligjit, sepse këtë dënim e ka zbutur deri në atë masë sa që bie në kundërshtim me rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit që kanë të bëjnë me zbutjen ose ashpërsimin e dënimit dhe kufijtë e kësaj zbutje. Rrethanat lehtësuese çfarëdo qofshin ato, as sesi, në rastin konkret nuk kanë guxuar të vlerësohen se janë të asaj rëndësi që do të ndikonin që dënimi i parashikuar ligjor për këtë veprë penale të zbutet gjerë në këtë nivel, ashtu që të akuzuarës ti shqiptohet dënim minimal dhe atë me kusht minimal. Çka do të thotë se nuk i ka vlerësuar fare rrethanat rënduese, pasi që e akuzuara me veprimet e saj e ka dëmtuar autoritetin dhe integritetin e zyrtarit policor gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, se veprimet e të akuzuarës ndikojnë në reflektimin negativ në raport me performancën në përgjithësi të zyrtarëve policor, por edhe me uljen e besimit të opinionit në fuqinë e gjyqësorit për të ndaluar kryerjen e këtyre veprave penale të kësaj natyre që janë të asaj rëndësie që përmes marrjes së vendimeve gjyqësore për të mbrojtur integritetin dhe autoritetin e tyre. Sipas prokurorit të shtetit me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht të akuzuarës, gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh vetëm rrethanat lehtësuese që janë të cekura në arsyetimin e aktgjykimin të ankimuar, ndërsa rrethanat rënduese si shkallën e përgjegjësisë penale, kryerjen e veprës penale me dashje dhe vetëdije të plotë, si dhe veprimet e tjera që paraqesin shqetësim në mospërfilljen ndaj zyrtarit policor, që do të thotë se me dënime kaq të buta nuk do të arrihet qëllimi i dënimit. Duke i pasur parasysh të gjitha këtë që u thanë më lartë, me të drejtë konsiderojmë se dënimet e tilla nuk do të

parandalohet kryerja e veprave penale të kësaj natyre e që në kohet e fundit janë në rritje e sipër po ashtu me këtë dënime nuk do të arrihet qëllimi i shqiptimit të sanksionit penal të përcaktuara me dispozitat ligjore.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e më sipërme ankimore të prokurorit për një dënim më të ashpër, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë konform dispozitave të nenit 74 të KPRK-së, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, me ç' rast si rrethanë lehtësuese për të akuzuarën mori parasysh faktin se e njëjta e ka pranuar fajësinë, se është penduar thellë për veprën penale të kryer, për herë të parë është ndeshur me ligjin si dhe ndaj saj nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, premtimin e saj se në të ardhmen nuk do të kryej vepër tjetër penale, ndërsa si rrethana rënduese për të njëjtën gjykata e shkallës së parë nuk ka gjetur. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë, e gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, pretendimi i prokurorit se dënimi i shqiptuar nuk ka mbështetje ligjore dhe se gjykata nuk ka marrë për bazë rrethanat rënduese në rastin konkret, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk është i bazuar, ngase duke marrë parasysh peshën e veprës penale dhe rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë del se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, e me qenë se në ankesën e prokurorit nuk theksohet ndonjë rrethanë e re rënduese, e që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë dhe që do të ndikonte në shqiptimin e ndonjë dënimi më të ashpër, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, ndaj të akuzuarës është në përpjesëtim me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarës si ekzekutore dhe se ky dënim do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me dënimin e shqiptuar kryerësja do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i saj dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.6/19, datë 22.01.2019

Zyrtari ligjor
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani
Biljana Rexhiq